

NJOFTIM

Sot, më datë **20.06.2023**, ora **09:00**, trupi gjykues i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga gjyqtarët:

- 1. Alma Kolgjoka (Relatore);**
- 2. Manjola Xhaxho (Anëtare);**
- 3. Esmeralda Xhili (Anëtare);**
- 4. Emona Muçi (Anëtare);**
- 5. Edlira Petri (Anëtare);**

në seancë gjyqësore të zhvilluar në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit, në adresën: Rr.“Ismail Qemali”, Tiranë, pasi shqyrtoi çështjen Nr.33 Regj.Themeltar, Datë 13.06.2023 Regjistrimi, me:

PADITËSA: - Lefter Maliqi, përfaqësuar nga Av. Arben Llangozi dhe Av.Orgesa Serani.
- Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.

TË PADITUR: - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror, përfaqësuar nga Znj. Ina Osmanaj.

PERSON I INTERESUAR: Subjekti Zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Av. Maringlen Legisi.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për rrezimin e pikës 1 të ankimit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ku kam kërkuar, hapjen e kutive për rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr.64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatit e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë, (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

BAZA LIGJORE: Neni 124 e vijues i Kodit Zgjedhor, neni 4, 13, 14, 23, 24, 90, 109, 116 i Kodit të Procedurave Administrative.

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me vendim të ndërmjetëm, vendosi **bashkimin e kësaj çështje me çështjen nr.34 Regj. Themeltar, Datë 13.06.2023 Regjistrimi**, me:

PADITËS: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga Av. Franci Nuri.

TË PADITUR: - Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve, pranë Komisionit Qendror Zgjedhor.
- Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve pranë Komisionit Qendror, përfaqësuar nga Znj. Ina Osmanaj.

OBJEKTI: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve për rrëzimin e ankimit Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) ku kam kërkuar, hapjen e kutive për rinumërim dhe rivlerësim i votave për KZAZ-në nr.64, të gjitha QV-të duke përfshirë në të rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi i votave për QV-të e listuara në tabelë, (KAS) duke vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për gjykim pranë KAS.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes Nr.33 Regj.Themeltar, Datë 13.06.2023 Regjistrimi, me Vendimin Nr. 31, datë 20.06.2023, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, unanimitisht,

VENDOSI

1. Pushimin e gjykimit.
2. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
3. Ky vendim është përfundimtar dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë më datë 20.06.2023.

Tiranë, më 20.06.2023

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë